

# Villafalt 2K

Pastë hidroizoluese me dy përbërës

## PRODUKTI

Villafalt 2K është një pastë hidroizoluese me dy përbërës, e pasuruar me polimer, rezistente ndaj ujit të ftohtë me një bazë emulzioni bituminoz. Ajo është e përgatitur për përdorim direkt në vendin e aplikimit, duke përzier të dy përbërësit bashkë. Villafalt 2K nuk përmban lëndë tretëse organike, prandaj është shumë miqësore me mjedisin. Proçesi i prodhimit dhe kontrolli i cilësisë së tij, janë të çertifikuara sipas standartit EN ISO 9001.

## KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

Villafalt 2K pas proçesit të tharjes, është rezistente ndaj ujit. Për shkak të trajtës së saj si pastë, mund të aplikohet në trashësi të mëdha dhe në sipërfaqe vertikale për shkak të tharjes së saj të shpejtë në temperatura të ulëta ose ambiente jo të ajrosura mirë. Materiali ka veti ngjitëse të shkëlqyer për ngjitjen afatgjatë të fugave të paneleve termoizolues dhe është mjaft fleksibël për të mbushur plasaritjet e holla.

## APLIKIMI DHE PËRPUNIMI

Villafalt 2K është e përshtatshme për hidroizolimete elastike, të përforcuara me fibra xhami, të Villas, sipas standartit austriak ÖNORM B 2209 apo DIN 18195 por është posaçërisht i përshtatshëm për ngjitjen e perimetrit të paneleve termoizolues me shumë. Kur aplikohet në sipërfaqe bituminoze të veshur me fletë, duhet të nxehet paraprakisht me flakë që ngjitja të mund të bëhet më mirë. Sipërfaqja duhet të jetë e thatë, e pastër dhe pa grimca të materialit, pa dhera, vaj ose papastërti të tjera. Të gjitha nënshtresat me bazë minerale duhet të mbulohen me astar Villas Emulbit. Aplikimi bëhet direkt nga kova, pas përzierjes, duke e aplikuar me një mistri dhe furçë.



**BMI**

**VILLAS**

[www.bmigroup.com](http://www.bmigroup.com)

## TË DHËNA TEKNIKE (të përcaktuara në temperaturë 20 ° C / lagështia e ajrit 60%)

<b>Karakteristikat e nënshtresës</b>	e thatë ose pak e lagur, gur me nyje të gjera, beton, llaç dhe të gjitha nënshtresat e tjera minerale
<b>Përzjerja</b>	Shtohet përbërësi pluhur te përbërësi i lëngshëm (jo anasjelltash!) dhe të përzihen ngadalë me ndihmën e përziersit elektrik derisa të formohet një masë homogjene dhe pa kokriza
<b>Raporti i përzjerjes</b>	A : B 4 : 1
<b>Temperatura e përpunimit</b>	në temperaturë të jashtme nga + 5°C në sipërfaqe jo të ngrira dhe maksimumi deri +35° C
<b>Koha e përgatitjes</b>	rreth 2 orë në 20° C në 60% lagështi relative të ajrit
<b>Koha e tharjes</b>	Në varësi të temperaturës së ajrit, lagështisë relative të ajrit si dhe veçorive të bazës:  Mbushja e gropave, rreth 2 ditë pas aplikimit të fundit, në 20° C / lagështia relative e ajrit 60% pas rreth 24 orësh.
<b>Rezistenca ndaj kushteve atmosferike</b>	Pas rreth 2 orësh në 20° C / 60% lagështi relative e ajrit
<b>Konsumi</b>	Për 1 mm trashësi të aplikimit rreth 1,1 Kg/m <sup>2</sup>
<b>Papërshkueshmëria nga uji</b>	7 bar
<b>Rezistenca ndaj rrezeve UV</b>	rezistent ndaj ekspozimit afatshkurtër, direkt të rrezeve UV
<b>Qëndrueshmëria</b>	Rezistente ndaj të gjitha substancave natyrale në dysheme, të tretshme në ujë.
<b>Dorëzimi</b>	30 kg (përbërësi A = 24 kg + përbërësi B = 6 kg); 12 kova/paletë = 360 kg
<b>Numri i produktit</b>	100741
<b>Mënyra e pastrimit</b>	- në kohën gjatë apo pas aplikimit, menjëherë me ujë - pas tharjes me pastrues tretës

Vlerat e dhëna janë nominale dhe subjekt i variacioneve statistikore. I nënshtrohen ndryshimeve teknike. Është detyrim i përdoruesit për të vlerësuar përputhshmërinë e specifikimeve të produktit dhe të sigurohet që ka një version të vlefshëm të fletës së të dhënave teknike.



---

## MAGAZINIMI

---

Në vend të freskët dhe të thatë paketimet e mbyllura origjinale mund të ruhen për rreth 6 muaj.